

SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "TRAJTIMI STUDENTEVE" SH.A, Korçe është regjistruar pranë Zyres Se Rregjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me Vendimin Nr. 33806/1 datë 14/07/2005. Aksioneri i vetëm është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila zoteron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, i cili është i regjistruar në vlerën 481,412,000 leke. Shoqëria administrohet nga z. Shkëlqim Kajmaku.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 Shoqëria kishte mesatarisht 17.44 punonjës .

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe dhe ligjin 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlërësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç

përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2020 është si më poshtë:



Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5 %
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Të Tjera jo materiale	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Inventar ekonomik	Vlera e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlera e mbetur	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të

vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatuueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabël, aktivet**4. Aktive monetare**

Gjëndja e aktiveve monetare në datë 31.12.2022 është në shumën 1,116,871 lekë, si më poshtë:

Nr	Likujditete	Viti 2022	Viti 2021
1	Depozita ne bankë	1,116,871	5,004,762
2	Para ne arkë	-	-
	Totali	<u>1,116,871</u>	<u>5,004,762</u>

E detajuar sipas bankave gjëndja e tyre më 31.12.2020 paraqitet si më poshtë:

Nr	Llogaria bankare	Gjendje ne lekë me 31.12.2022
1	Raiffeissen Bank	793,718
2	Fi Bank	323,153
	Shuma	<u>1,116,871</u>

5. Të drejta të arkëtueshme

ëe këtë post paraqiten të drejta tëë arkëtueshme, për qeranë e të tjera, me 31.12.2022 në shumën 1,206,042 lekë, si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Klient për qera	506,042	586,042
2	Detyrime MAS(Mbështetje financiare	700,000	
	Shuma	<u>1,206,042</u>	<u>586,042</u>

6. Inventaret

Gjëndja e inventarit të materialeve dhe inventarit të imët më 31.12.2022 është 1,083,015 lekë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Materiale	527,954	540,178
2	Inventar I imët	555,061	621,566
	Totali	<u>1,083,015</u>	<u>1,161,744</u>

- ❖ Vleresimi i mallrave në momentin e blerjes është bërë me koston e hyrjes veprimet e daljes e të gjendjeve të inventarit janë bërë me kosto mesatare e cila nuk ka ndryshuar ne vite.
- ❖ Të gjitha transaksionet e kryera si blerje, shitje, kalim në llogarite e shpenzimeve vjetore i përkasin ushtrimit kontabël të vitit 2022.

7. Aktive afatgjata materiale

Si politikë kontabël për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me kosto dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Drejtimi nuk ka llogaritur rënie të vlerës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021.

Gjëndja e aktiveve më 31.12.2022 është 549,610,504 lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Truall dhe ndërtesë	Mjete transporti	Makinieri e pajisje	Të tjera në shfrytëzim	Totali
	Aktive afat gjata					
I	materiale					
1	Gjendja më 31.12.2021	712,882,465	8,999,000	55,039,401	2,086,903	779,007,769
2	Shtesat për 2022	62,400,000	-	0	0	62,400,000
3	Pakësimet për 2022	(4,000)	-	(465,521)	(122,000)	(591,521)
4	Gjendja më 31.12.2022	<u>775,287,465</u>	<u>8,999,000</u>	<u>54,573,880</u>	<u>1,964,903</u>	<u>840,816,248</u>
II	Amortizimi I AQT-ve					
1	Gjendja më 31.12.2021	236,242,416	8,591,262	31,179,027	1,019,869	277,032,574
2	Shtesat për 2022	9,317,002	81,548	4,772,075	266,758	14,737,383
3	Pakësimet për 2022	-	-	(444,107)	(120,106)	(564,213)
4	Gjendja më 31.12.2022	<u>245,859,418</u>	<u>8,672,810</u>	<u>35,506,995</u>	<u>1,166,521</u>	<u>291,205,744</u>
III	Vlera neto 31.12.2022	<u>232,119,047</u>	<u>326,190</u>	<u>19,066,885</u>	<u>798,382</u>	<u>549,610,504</u>

**Bilanci kontabël, pasivet
Detyrimet Afatshkurtra**

8. Detyrimet Afatshkurtra

Në këtë post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra më 31.12.2022 në shumën 2,296,166 lekë, si më poshtë :

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2022	Viti 2021
1	Detyrime për furnitorë	524,514	406,808
2	Parapagime të marra(Garanci për studentët)	397,200	231,200
3	Detyrime ndaj MFE	356,700	356,700
4	Detyrime për paga/sigurime	852,067	916,880
5	Detyrime tatimore (tatim në burim)	12,690	12,720
6	Të tjera të pagueshme (K.mbikqyrës)	71,995	72,080
	Shuma	<u>2,215,166</u>	<u>1,996,388</u>
7	Të ardhura të shtyra	81,000	77,900

8.1 Të pagueshme ndaj furnitorëve

Gjendja e furnitorëve të palikujduar është 524,514 lekë. Lista e furnitorëve paraqitet si më poshtë :

Nr	Detyrime për furnitorë	Shuma ne leke
1	FSHU ,Fatura nr 442536990 datë 26.11.2022,443559361 date 27.12.2022	250,706
2	UKK ,Fatura nr 48401,57906,67529 datë19.12.2022	37,210
3	Vodafone.al,fatura 383049/2022,datë 31.12.2022	6,500
4	Albtelecom ,Fatura 502/2022 datë 31.12.2022	3,000
5	Lico TEC ,Fatura 56/2022,datë 22.12.2022	16,698
6	Eva Zoto ,Fatura 9/2022 datë 30.12.2022	117,600
7	Tome gaz ,Fatura 1894/2022 datë 31.12.2022	56,800
8	Ergi Pink,Fatura 366/2022 datë 23.11.2022	<u>36,000</u>

Shuma

524,514

8.2 Parapagime të marra

Paraqitet detyrimi i shoqërisë për parapagimet e marra si garanci për studentët në shumën 231,200 lekë, deri më 31.12.2022.

8.3 Detyrime ndaj Ministrisë së financave dhe Ekonomisë

Paraqitet detyrimi i shoqërisë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në shumën 356,700 lekë, deri më 31.12.2022.

8.4 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore

Paraqitet detyrimi i shoqërisë paga e sigurime shoqërore e shëndetësore gjithsej në shumën 852,067 lekë, deri më 31.12.2022, nga të cilat detyrimi për sigurime shoqërore e shëndetësore i muajit dhjetor 2022 është 283,612 lekë.

8.5 Detyrime tatimore

Janë pasqyruar detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit në shumën 12,690 lekë më 31.12.2022, shumë e cila përfaqëson detyrimin për tatimin në burim në shumën 12,690 lekë.

8.6 Të tjera të pagueshme

Janë pasqyruar detyrimet të tjera të shoqërisë për pagesën e Keshillit Mbikqyrës deri më 31.12.2022, në shumën 71,995 lekë.

9. Të ardhura të shtyra

Në këtë post paraqiten të ardhura të periudhave të ardhshme në shumën 81,000 lekë, si më poshtë :

Nr	Të ardhura të shtyra afatshkurtra	Viti 2022	Viti 2021
1	Vlera e arkëtimeve si vit akademik, por që i takojnë vitit të ardhshëm kalendarik	81,000	77,900
	Shuma	<u>81,000</u>	<u>77,900</u>

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë më të detajuar llogaritjen e vlerës së mësipërme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Të ardhura të shtyra nga viti I mëparshëm	77,900	119,000
2	Arkëtime për vitin 2022	2,407,345	476,150
3	Kalim në të ardhura të vitit	(2,404,245)	(517,250)
	Shuma	<u>81,000</u>	<u>77,900</u>

Bilanci kontabël, pasivet

Detyrimet Afatgjata

10. Të ardhura të shtyra

Në këtë post paraqiten të ardhura të shtyra afatgjata, në shumën 81,424,440 lekë, të detajuara si më poshtë :

Nr	Të ardhura të shtyra afatgjata	Viti 2022	Viti 2021
1	Automjet falas nga Avokatura e Shtetit	485,462	567,010
2	Pajisje akomoduese nga Fondi Shqiptar I zhvillimit	19,188,978	23,688,259
3	Rikonstruksion godina vajza nga Fondi Shqiptar I zhvillimit	61,750,000	0

Shuma **81,424,440** **24,255,269**

11. Kapitali

Grupi i kapitaleve të veta është pakësuar me humbjen e vitit 2021 në shumën 13,102,360 lekë. Totali i kapitaleve të veta më 31.12.2022 është 469,295,826 leke. Struktura e tij paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva Rivleresimi	Rezerva ligjore	Fitime/humbje te mbartura	Fitim/humbje te vitit	Totali
1	Gjendja më 31.12.2021	481,412,000	45,771,446	539,507	(32,161,545)	(13,163,222)	482,398,186
2	Shtesat për 2021			-		(13,102,360)	(13,102,360)
3	Pakësimet për 2022	-			(13,163,222)	13,163,222	-
	Gjendja më 31.12.2022	481,412,000	45,771,446	539,507	(45,324,767)	(13,102,360)	469,295,826

Pasqyra e Performancës**12.1 Të ardhura nga aktiviteti kryesor**

Në këtë post janë paraqitë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Akomodimi I studentëve	2,915,815	675,250
	Shuma	2,915,815	675,250

Të ardhurat e arkëtuara nga studentët për vitin 2022 kanë kaluar në të ardhura vetëm pjesa për 3 mujorin e fundit të 2022 kurse diferenca kalon si e ardhur që do të kontabilizohet për vitin 2023, në shumën 81,000 lekë, e paraqitur në zërin "Të ardhura të shtyra". Kjo e ardhur llogaritet duke pjestuar shumën e arkëtuar për 2022 me 10 (muaj akomodimi në konvikt) dhe duke e shumëzuar me 3 (muaj që i perkasin 2022, Tetor - Dhjetor).

Arkeëimet nga studentët paraqiten më të detajuara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Rimarrje të ardhura nga viti 2021	77,900	119,000
2	Arkëtime nga studentët për vitin 2022	2,918,915	634,150
3	Të ardhura të shtyra që i takojnë 2023	(81,000)	(77,900)
	Shuma	2,915,815	675,250

12.2 Të tjera të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Në këtë post paraqiten të ardhurat e tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit të cilat përfaqësojnë vlerën e subvencioneve të marra nga Ministria e Financave për vitin 2022, në shumën 9,070,472 lekë, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Subvencione nga MFE	9,070,472	11,500,000
	Shuma	9,072,472	11,500,000

12.3 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Në këtë post paraqiten të ardhurat e tjera të shfrytëzimit të cilat përfaqësojnë të ardhurat përfaqësojnë rrimarrjen e granteve për vitin 2022, në shumën 5,230,829 lekë, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
----	----------	-----------	-----------

1	Rrimarrje grantesh	5,230,829	5,726,037
	Shuma	<u>5,230,829</u>	<u>5,726,037</u>

12. Lende e pare dhe materialet te konsumueshme

Shuma e materialeve të konsumuara për vitin 2022 është 1,377,360 lekë, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Materiale të konsumuara	1,377,360	770,384
	Shuma	<u>1,377,360</u>	<u>770,384</u>

13. Kostot e punës

Kosto e punës për vitin 2022 është në shumën 10,291,484 lekë e detajuar si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Shpenzime për paga	8,818,752	9,354,149
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,472,732	1,562,160
	Shuma	<u>10,291,484</u>	<u>10,916,309</u>

Përmbledhësja e pagave për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Nr	Muaji	Nr punonj	Paga Totale Bruto	Paga mbi të cilën llog. kontributet	Kontribut. Punëdhënësi	Kontribut Punëmarrësi	Tatimi në lekë	Paga neto
1	Janar	17	743,080	743,080	124,095	83,226	30,299	629,555
2	Shkurt	17	748,977	748,977	125,079	83,886	31,067	634,024
3	Mars	17	777,730	777,730	129,881	87,108	34,805	655,817
4	Prill	17	771,132	771,132	128,779	86,368	27,160	657,604
5	Maj	18	784,379	784,379	130,992	87,853	22,016	674,510
6	Qershor	18	723,714	723,714	120,860	81,057	19,409	623,248
7	Korrik	18	708,900	708,900	118,386	79,398	19,409	610,093
8	Gusht	18	691,445	691,445	115,471	77,443	19,409	594,593
9	Shtator	17	691,200	691,200	115,430	77,416	19,409	594,375
10	Tetor	17	658,900	658,900	110,037	73,798	18,252	566,850
11	Nëntor	17	645,332	645,332	107,770	72,278	18,252	554,802
12	Dhjetor	17	873,963	873,963	145,952	97,888	39,776	736,299
	Shuma		8,818,752	8,818,752	1,472,732	987,719	299,263	7,531,770

Në tabelën e mëposhtme paraqitet informacion në lidhje me shumën e shumën e pagave që u jepet për periudhën raportuese anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese si edhe numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese, të zbërthyer sipas kategorive dhe kostot e personelit në lidhje me periudhën raportuese, të zbërthyer sipas pagave, kostove të sigurimeve shoqërore.

Nr	Shpërblimet e pagave sipas strukturës	Nr Punonj	Paga bruto	Sigurimet 16.7%
1	Administratori	1	1,219,300	203,623
2	Administrata	5	2,721,592	454,506

3	Sek. e sporteve	5	1,857,243	310,160
4	Sek. e shërbimeve	7	2,512,487	419,585
5	Sek. Sanitare	1	508,130	84,858
	Shuma		<u>8,818,752</u>	<u>1,472,732</u>

14. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Është llogaritur amortizimi i asetëve për vitin 2022 sipas normave ligjore në shumën 14,737,383 lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Amortizimi I aktiveve	14,737,383	15,869,147
	Shuma	<u>14,737,383</u>	<u>15,869,147</u>

15. Shpenzime të tjera

Shpenzime ëe tjera paraqiten në shumën 3,885,705 lekë dhe janë përfshirë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	3,885,705	3,484,069
	Shuma	<u>3,883,705</u>	<u>3,484,069</u>

Të detajuara shpenzimet e tjera të vitit 2022 paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022
	Shpenzime me faturë tatimore	
1	Furnizim me Ujë	450,673
2	Energji elektrike	1,454,838
3	Sigurim I objektit	166,000
5	Internet,celular,posta	114,329
6	Program fiskalizimi,shërbim kompjut.	34,490
8	Taksat vendore+automjeti	105,620
9	Auditimi I pasqyrave financiare 2021	150,000
11	Dezifektim ambientesh	55,280
12	Shërbime në territorin e gjelbër	85,500
13	Reklamë e njoftime,shërbim postar	16,000
164	Shërbime mbushje gaz+kontroll teknik	63,075
	Shuma e shërbimeve me fature	<u>3,885,705</u>

Shpenzime pa fature tatimore

1	Vlera kontabël e aktiveve të dala j. përdorimit	27,300
2	Shperblim per keshillin mbikqyres	1,017,415
3	Sherbime e dieta	<u>145,000</u>
	Shuma shpenzime pa fature tatimore	1,189,715

Shpenzime për keshillin mbikqyrës për vitin 2022 paraqiten si më poshtë :

Kësh mbikqyrës	nr	shpërblimi bruto	TAP	Shpërblimi neto
Kryetar	1	416,700	62,505	354,195
Anetar	2	555,600	83,340	472,260

Sekretar	1	45,000	6,750	38,250
TOTALI	4	1,017,300	152,595	864,705

-Shpenzime për auditimin e pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë :

Numuri I audituese 2(dy) tarifa 75,000 lekë shuma 150,000 lekë

16. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime në shumën 24,600 lekë për vitin 2022, të detajuara si më poshtë :

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Komisione bankare	27,544	24,600
	Shuma	<u>27,544</u>	<u>24,600</u>

17. Llogaritja e tatimit të fitimit

Llogaritja e rezultatit të shoqërisë paraqitet në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Shoqëria për vitin e mbyllur më 31.12.2022 është me humbje në shumën 13,102,360 lekë.

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
1	Të ardhura nga aktiviteti	2,915,815	675,250
2	Të ardhura të tjera të shfrytezimit	14,301,301	17,226,037
	Totali i të ardhurave	<u>17,217,116</u>	<u>17,901,287</u>
3	Shpenzime	(30,319,476)	(31,064,509)
4	Rezultati i ushtrimit	<u>(13,102,360)</u>	<u>(13,163,222)</u>
5	Shpenzime të pazbritshme	-	-
6	Rezultati tatimor	<u>(13,102,360)</u>	<u>(13,163,222)</u>
7	Tatim fitimi	-	-
	Fitimi neto	<u>(13,102,360)</u>	<u>(13,163,222)</u>

18. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta.

19. Ngjarje pas datës së Bilancit

Ngjarje pas datës së bilancit mund të jenë situata e krijuar gjatë periudhës së fatkeqesisë natyrore.

Hartuesi i Pasqyrave

Mimoza Mançelli



Administratori

Shkëlqim Kajmaku



Aktivet Afatgjata Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2022
1	NDERTES.RRUG.TROTUA		415,582,465	62,400,000	4,000	477,978,465
2	INST. TEKN.MAK.PAJISJE		55,039,401		465,521	54,573,880
3	MJETE TRANSPORTI		8,999,000			8,999,000
4	PAJISJE KOMPJUTERIKE		2,086,903		122,000	1,964,903
5	TOKA(TRUALLI)		297,300,000			297,300,000
6						0
7						0
8						0
9						0
	TOTALI		779,007,769	62,400,000	591,521	840,816,248

Amortizimi A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31.12.2022
1	NDERTES.RRUG.TROT		236,242,416	9,617,002		245,859,418
2	INST.TEKN.MAK.PAJISJE		31,179,027	4,772,075	444,107	35,506,995
3	MJETE TRANSPORTI		8,591,262	81,548		8,672,810
4	PAJISJE KOMJUTERIKE		1,019,869	266,758	120,106	1,166,521
5	TOKA(TRUALLI)		0			0
1						0
2						0
3						0
4						0
	TOTALI		277,032,574	14,737,383	564,213	291,205,744

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2022

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01.01.2022	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2022
1	NDERT.RRUG.TROT		179,340,049	62,400,000	9,621,002	232,119,047
2	INST.TEKN.MAK.PAJISJE		23,860,374	444,107	5,237,596	19,066,885
3	MJETE TRANSPORTI		407,738	0	81,548	326,190
4	PAJISJE KOMJUTERIKE		1,067,034	120,106	388,758	798,382
5	TOKA(TRUALLI)		297,300,000	0	0	297,300,000
6				0	0	0
7				0	0	0
8				0	0	0
9				0	0	0
	TOTALI		501,975,195	62,964,213	15,328,904	549,610,504


Administratori
Shkëlqim Kajmaku